



TRANSPARENCA E VETËQEVERISJES LOKALE NË VERI TË KOSOVËS

QËNDRIMET E QYTETARËVE

Botues

Instituti për zhvillim ekonomik (InTER)

Për botuesin

Dragisa Mijacic

Autorë

Jovana Jakovljevic

Dragisa Mijacic

Jasna Zarkovic

Marija Milenkovic

Viti

2018

TRANSPARENCA E VETËQEVERISJES LOKALE NË VERI TË KOSOVËS

Qëndrimet e qytetarëve

Dhjetor 2018

PËRMBAJTJA

I HYRJE	1
II METODOLOGJIA	2
III PROFILI I TË ANKETUARVE	4
IV QËNDRIMET NDAJ TRANSPARENCËS KOMUNALE	6
Niveli i informimit lidhur me punën e komunës	6
Metodat e përdorura për shpërndarjen e informatave mbi	8
Nivelet e kënaqshmërisë me aktivitetet komunale të informimit	11
Zyrtarët komunalë për informim	12
Përmirësimi i transparencës së autoriteteve komunale dhe	14
Njohuria për statutet komunale	16
Ndikimi i banorëve në proceset lokale të vendim-marrjes	17
Mekanizmat për paraqitjen e qëndrimeve të publikut mbi problemet	19
Komunikimi i drejtpërdrejtë mes banorëve dhe përfaqësuesve.....	21
Prania e banorëve në takimet publike ose seancat e kuvendit.....	23
Pjesëmarrja e publikut në miratimin e buxhetit komunal	26
Qasja në dokumente publike	28
Ndërgjegjësimi lidhur me buxhetin komunal.....	29
Ndërgjegjësimi rreth infrastrukturës komunale ose projekteve	29
V KONKLUDIM	34
SHTOJCA 1	36
SHTOJCA 2	38

I HYRJE

Të kuptuarit e parimeve të lidhura me transparencën e pushtetit lokal dhe proceseve të vendim-marrjes janë qenësore për arritjen e pjesëmarrjes së banorëve në zhvillimin e politikave lokale, por është edhe parakusht për funksionimin efikas të pushteteve lokale. Këto pushtete janë të pozicionuara ashtu që të jenë sa më të afërta me banorët në hierarki të një sistemi të vetëm politik, duke i bërë ato organe të cilave banorët iu drejtohen më së shpeshti. Për të përmirësuar standardet e jetesës së tyre, të gjithë banorët kanë të drejtë, por edhe obligim, që të ndikojnë tek vendim-marrësit në nivel lokal. Ngjashëm, autoritetet lokale janë të obliguara të konsultojnë banorët kur vendosin për politikat relevante.

Për të mbledhur informata dhe të dhëna për perceptimin e banorëve që banojnë në komunat veriore të Kosovës, sidomos kur bëhet fjalë për përgjegjësitë e tyre ndaj vetëqeverisjes lokale, Instituti për Zhvillim Ekonomik Territorial (InTER) ka ndërmarrë një hulumtim të gjerë, rezultatet e të cilit janë paraqitur në këtë punim.

Ky studim paraqet gjetjet kryesore nga hulumtimi që shënjestron veriun e Kosovës, duke u fokusuar tek transparencja e pushteteve lokale. Hulumtimi është kryer në periudhën prill-shtator 2018, në katër komunat me shumicë serbe: Laposaviq, Mitrovicë Veriore, Zubin Potok dhe Zveçan. Ky punim përbëhet nga pesë kapituj. Pas hyrjes, kapitulli i dytë merret me metodologjinë e hulumtimit, derisa i treti ofron një pasqyrë të profilit të të anketuarve që është përdorur në hulumtim. Kapitulli i katërt paraqet gjetjet kryesore të hulumtimit, duke përfshirë analizën individuale të përgjigjeve të dhëna ndaj secilës pyetje të pyetësorit. Pjesa e fundit përmban vërtetimet përfundimtare mbi transparencën e punës së komunave në veri të Kosovës.

II METODOLOGJIA

Metodologjia e hulumtimit ka përfshirë përdorimin e mjeteve të ndryshme metodologjike cilësore e sasiore që janë aplikuar gjatë fazave të ndryshme të hulumtimit.

Në fillim, është përcaktuar mostra statistikore që duhej testuar. Mostra përfshinte banorët e komunave Leposaviq, Mitrovicë Veriore, Zubin Potok dhe Zveçan. Numri i të anketuarve sipas komunave është përcaktuar në bazë të shifrave të përafërta të popullsisë që janë dhënë në Raportet e Profileve Komunale të Misionit të OSBE-së në Kosovë¹, sipas të cilave janë rreth 80.000 banorë në veri të Kosovës. Në përputhje me këtë numër të përafërt të banorëve, madhësia e përcaktuar e mostrës ishte 597 subjekte, me shkallë konfidence prej 95% si dhe shkallë gabimi statistikor prej $\pm 4\%$ (siç ilustron tek *Tabela e Shtojcës 1*).²

Duke marrë parasysh që nuk ka pasur regjistrim të popullsisë në veri të Kosovës për tri dekada me radhë, struktura gjinore dhe moshore e banorëve është nxjerrë në bazë të një vlerësimi të përafërt të komunave në veri të Kosovës, me komunat me karakteristika të ngjashme demografike dhe urbane në Serbi.

Pas përfundimit të përkufizimit të mostrës, është hartuar pyetësori me 18 pyetje (Shtojca 2), i cili është ndarë në dy pjesë: a) të dhënat e përgjithshme për banorët, si dhe b) qëndrimet e tyre mbi transparencën e punës së komunave. Në Mitrovicën e Veriut, janë shpërndarë 220 pyetësorë; Leposaviq - 139 pyetësorë; Zveçan - 124

¹ Profilet komunale, Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), Misioni në Kosovë, gjendet në <http://bit.ly/2spJfkS>

² Teknikat e mostrimit në hulumtime arsimore, Autor: Dr. E. Dhivyadeepa, faqet 20 dhe 21, gjendet në <https://bit.ly/2KmFJ42>

pyetësorë; si dhe në Zubin Potok 114 pyetësorë. Për të vlerësuar formulimin dhe qartësinë e pyetjeve, pyetësori është testuar paraprakisht.

Në fazën përfundimtare të anketës, analiza e të dhënave është kryer me anë të SPSS-së - program i përpunimit të të dhënave statistikore. Përveç të dhënave të grumbulluara përmes anketës, InTER ka bërë edhe hulumtime në zyrë, duke grumbulluar e përpunuar të dhëna nga korniza ligjore e Kosovës që ka të bëjë me transparencën komunale, si dhe të dhëna nga literatura profesionale, e hulumtime të tjera të ngjashme. Rezultatet përfundimtare të të gjitha këtyre analizave janë paraqitur në këtë raport.

III PROFILI I TË ANKETUARVE

Gjatë sondazhit të ndërmarrë nga INTER në katër komunitat e veriut të Kosovës (Leposaviq, Mitrovicë Veri, Zubin Potok dhe Zveçan), janë shpërndarë 597 pyetësorë tek banorët. Tabela 1 si më poshtë ofron pasqyrim më të hollësishme të strukturës së banorëve sipas vendbanimit të tyre, gjinisë, moshës, nivelit të arsimimit, si dhe profesioneve të tyre.

Tabela 1. Profili i të anketuarve

Madhësia e mostrës: 597		%
Komuna	Mitrovicë Veriore	37,0
	Zveçan	20,7
	Zubin Potok	18,9
	Leposaviq	23,4
Gjinia	Mashkullore	48,3
	Femërore	51,7
Mosha	15-24	13,5
	25-34	16,4
	35-44	15,6
	45-54	14,9
	55-64	19,1
	65+	20,6
Niveli i arsimimit	Pa arsim formal	0,5
	Shkollë fillore	6,7
	Shkolla e mesme	56,2
	Shkolla e lartë	15,7
	Universiteti	20,9

Profesioni	I/e punësuar	44,5
	Pensionist	24,1
	Amvise	5,2
	I/e papunë	13,2
	Student	11,5
	Të tjerë	1,5

Numri më i madh i të anketuarve vjen nga Mitrovica e Veriut, gjë që është në përpjesëtim me numrin e banorëve, krahasuar me komunat tjera. Sa i përket strukturës gjinore, 48.3% të të anketuarve ishin burra, ndërsa 51.7% të të anketuarve ishin gra. Mes të anketuarve, më se gjysma janë persona me nivel të shkollimit të mesëm, në fakt 56.2%, derisa 44.5% e të anketuarve në kategorinë e profesionit kanë deklaruar që janë të punësuar.

IV QËNDRIMET NDAJ TRANSPARENCËS KOMUNALE

Niveli i informimit lidhur me punën e komunës

Të gjitha komunat e trajtuara me këtë anketë kanë të rregulluara çështjet e transparencës ndaj banorëve, ndërveprimit me banorë apo pjesëmarrjen e banorëve në funksionimin e pushtetit lokal në mënyrë pak a shumë të ngjashme në statutet e tyre përkatëse komunale. Megjithatë, rezultatet e anketës tregojnë që ndarja e informatave nga komuna drejt banorëve nuk është në nivel të lartë, por edhe që dallon nga komuna në komunë. Kjo gjetje mund të interpretohet si komunikim i dobët me banorët, kryesisht për shkak të takimeve të rralla publike.

Kur pyeten se sa të informuar janë për punën e komunës, të anketuarit ofruan informatat vijuese:

Tabela 2. Niveli i informimit lidhur me punën e komunës

Sa të informuar jeni për punën e komunës?	%
Plotësisht i/e informuar	2,3
Kryesisht i/e informuar	11,7
Pjesërisht i/e informuar	32,3
Pak i/e informuar	30,6
I/e painformuar	23,1

Nga përgjigjet që janë dhënë në të gjitha komunat, mendimi i përgjithshëm është që të anketuarit janë pjesërisht të informuar për punën e komunës së tyre, si dhe më pak se 15% e të anketuarve

vlërësojnë që janë kryesisht apo plotësisht të informuar. Përgjigjet në këto pyetje tregojnë që mbi 80% e të anketuarve janë pjesërisht, pak dhe krejtësisht të paimformuar mbi atë se çfarë bëjnë organet e vetëqeverisjes lokale. Anketa më tutje ilustron që rezultatet më të dobëta në lidhje me informimin e qytetarëve janë në komunën e Zveçanit, ku deri në 81.5% e të anketuarve kanë thënë që janë të informuar më pak apo fare. Kjo gjë është posaçërisht interesante, duke marrë parasysh që është mu komuna e Zveçanit e vetmja komunë në veri të Kosovës që ka faqe interneti komunale, ku paraqiten informatat mbi punën e komunës.

Nuk ka dallime të mëdha gjinore në rezultat, pra kështu edhe burrat edhe gratë kanë informata gati të barabarta për punën e pushteteve lokale. Mes grupmoshave të ndryshme, përgjigjet dallojnë mes të rinjve në moshat 15-24 vjeç dhe atyre më të moshuar se 65 vjeç, që janë më së paku të informuar mbi punën e komunës. Rezultatet gjithashtu tregojnë që rrjedha e informatave përmirësohet tek ata që janë të punësuar, kur krahasohen me të papunët, pensionistët, studentët dhe nxënësit.

Sipas Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, neni 68³, si parim themelor i komunikimit të drejtpërdrejtë me banorë, komunat janë të obliguara të mbajnë së paku dy takime publike gjatë vitit, ku secili person apo organizatë e interesuar ka të drejtë të marrë pjesë. Megjithatë, sipas raportit të publikuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbi funksionimin e komunave për periudhën janar-qershor 2017, në mesin e komunave që nuk kanë organizuar asnjë

³ Ligji 03/L – 040 për Vetëqeverisjen lokale, gjendet në <https://bit.ly/2o1592C>

takim publik me qytetarë renditen edhe Leposaviqi, Mitrovica e Veriut, Zubin Potoku dhe Zveçani⁴.

Metodat e përdorura për shpërndarjen e informatave mbi veprimtarinë komunale

Si një prej metodave kryesore të informimit të qytetarëve mbi punën e komunës, merret parimi “përmes të njohurve / miqve që kanë njohuri për punën e komunës” që ka pjesën më e madhe dhe theksohet nga 35.2% e të anketuarve. Është me rëndësi të theksohet që të anketuarit kanë theksuar që interneti dhe rrjetet sociale janë vegla të rëndësishme për ndarjen e informatave, më shumë sesa televizionet apo radiostacionet lokale e rajonale. Qëndrimi që mbështet ndarjen e informatave në internet është i pranishëm tek të anketuarit në moshat 25 – 34 vjeç, derisa të anketuarit më të moshuar ende preferojnë të shfrytëzojnë metoda të ndryshme të sigurimit të informatave mbi punën e komunave.


Një gjetje tjetër e rëndësishme tregon që në mesin e të anketuarve më të rinj, ka interesim të paktë për të monitoruar e marrë pjesë në punën e komunave, pasi që 48.6% e të anketuarve në moshat 15 deri në 18 vjeç kanë deklaruar që nuk përdorin asnjë lloj burimi informatash për punën e komunës.

Nëse vërejmë metodat e ndryshme të shpërndarjes së informatave sipas komunave, ka dallime të dukshme varësisht nga aktiviteti i mediave lokale në monitorim të punës së autoriteteve komunale. Për shembull, në Leposaviq, 25% e të anketuarve përmendin kanalin televiziv lokal si burim kryesor të informatave për punën e komunës,

⁴ Raporti mbi funksionimin e komunave, janar-qershor 2018, gjendet tek <https://bit.ly/2M0UZDf>

pasi që RTV Mir regjistron dhe transmeton seancat e kuvendit komunal. Në anën tjetër, pa marrë parasysh aktivitetet e mediave lokale, të anketuarit nga Zveçani dhe Mitrovica e Veriut kanë më shumë gjasa të marrin informata mbi punën e komunave të tyre përmes mjeteve e burimeve të tjera të informimit. Më poshtë në Diagramin 1 është ofruar një pasqyrim i metodave të shpërndarjes së informatave mbi punën e komunave, në secilën komunë individualisht.

Diagrami 1. Mënyra e informimit të qytetarëve me punën e komunës, sipas komunave



Nivelet e kënaqshmërisë me aktivitetet komunale të informimit

Pavarësisht nga ekzistenca e akteve ligjore që rregullojnë transparencën komunale, siç është Ligji për Vetëqeverisje Lokale dhe Udhëzimi Administrativ për Transparencë në Komuna dhe për shkak të mungesës së zbatimit të tyre të plotë, banorët nuk janë të kënaqur me informacionin që marrin nga komunat. Andaj, vetëm tre të anketuar, ose 0.5% të numrit të përgjithshëm të të anketuarve, shprehën kënaqësinë e tyre me aktivitetet e kryera nga komunat në veri të Kosovës, në informimin e banorëve të tyre për punën e komunës. Nga ana tjetër, shumica e të anketuarve (47.8%) u përgjigjën se ishin pjesërisht të kënaqur me informatat që ishin në dispozicion për punën e komunave, ndërsa 45.1% e të anketuarve ishin më pak ose krejtësisht të pakënaqur.

Tabela 3. Niveli e kënaqësisë së qytetarëve me aktivitetet e komunës mbi informimin


Sa të kënaqur jeni me aktivitetet informuese të komunës suaj?	%
Plotësisht i/e kënaqur	0,5
Kryesisht i/e kënaqur	6,5
Pjesërisht i/e kënaqur	47,8
Pak i/e kënaqur	28,4
I/e pakënaqur	16,7

Sa i përket komunës prej nga vijnë, të anketuarit nga komunat e Mitrovicës Veriore (21.7%) si dhe Zubin Potokut (21.2%) janë më së paku të kënaqur me aktivitetet informuese të komunës. Gjetjet tregojnë që shumica e atyre që janë të kënaqur janë në kategorinë e të punësuarve, derisa 22.8% të papunëve, 20.8% të pensionistëve; 45.2% të amviseve dhe 21.7% të studentëve janë plotësisht të pakënaqur.

Zyrtarët komunalë për informim

Sipas Udhëzimit Administrativ për Transparencën Komunale, parashihet që komuna duhet të ofrojë qasje në dokumentet publike për publikun, mediat dhe palët tjera të interesuara në pajtim me kërkesat, përmes zyrtarëve të informimit⁵. Gjetjet për njohuritë e banorëve për ekzistencën e zyrtarëve komunalë për informim janë paraqitur në diagramin si më poshtë.

Diagrami 2. Njohja e qytetareve me ekzistimin e funksionit të zyrtarit për informim publik




Rreth 72% të të anketuarve janë përgjigjur negativisht në këtë pyetje, derisa statistikat më të këqija janë në komunën e Zveçanit, ku vetëm 9.7% të të anketuarve e dinë që ka apo duhet të ketë zyrtar komunal për informim. Një gjendje dukshëm më e mirë në këtë drejtim është në Mitrovicën e Veriut, ku 45.7% e të anketuarve kanë pak njohuri për ekzistimin e zyrtarëve komunalë për informim në komunën e tyre. Në

⁵ Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2015 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2013 për Transparencën në Komuna

dy komunat tjera, Zubin Potok dhe Leposaviq, rreth 80% e të anketuarve janë përgjigjur negativisht ndaj pyetjes së bërë.

Gjendja në terren me gjasë është edhe më keq, pasi që shumica e të anketuarve që kanë treguar vetëdije për nevojën për zyrtarë komunalë për informim nuk arrijnë të përkufizojnë saktë cilat janë apo duhet të jenë përgjegjësitë e zyrtarit komunal për informim. Në 56.4% të rasteve, ata janë pjesërisht të njoftuar me kompetencat përkatëse; 26.1% nuk janë të informuar plotësisht, ndërsa vetëm 17.6% të të anketuarve janë plotësisht të njoftuar me kompetencat e zyrtarëve komunalë për informim (shih Diagramin 3).

Diagrami 3. Njohja me kompetencat e zyrtarit për informim



Përmirësimi i transparencës së autoriteteve komunale dhe shërbimeve komunale


Korniza aktuale rregullative përcakton detyrimin e komunës që të publikojë informatat me rëndësi dhe me interes. Ligji për Vetëqeverisjen lokale nr. 03/L-040⁶ parasheh detyrimet e institucioneve komunale që të jenë transparente dhe të nxisin pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset vendim-marrëse. Përveç Ligjit, ekziston edhe Udhëzimi Administrativ nr. 01/2015 për transparencën në komuna, i cili parasheh se si organet komunale duhet të përkushtohen ndaj transparencës dhe qasjes së qytetarëve dhe palëve të tjera në veprimtarinë komunale⁷. Megjithatë, përkundër legjislacionit detyrues, banorët theksojnë që niveli i transparencës në komunat e veriut të Kosovës do të mund të ishte shumë më i lartë, ndërsa 45.1% e të anketuarve janë ose tejet ose plotësisht të pakënaqur me informatat publike që ofrohen nga komunat e tyre.

Kur pyeten se si do të përmirësohej transparenca, një numër i konsiderueshëm i të anketuarve (rreth 30%) insistojnë që faqja funksionale e internetit e komunës, si mjet i shpërndarjes së përditshme të informatave, do të ishte përmirësim i rëndësishëm. Megjithatë, ka edhe një numër të të anketuarve(20.3%) që theksojnë se pushteti lokal duhet të mbajë mbledhje/debate publike me banorët, ku do të diskutoheshin çështjet me interes për komunitetin. Përqindjen më të vogël (1.8%) e përbëjnë ata që si mënyrë e rritjes së transparencës së organeve dhe shërbimeve komunale propozojnë miratimin dhe zbatimin e një plani veprimi për transparencën e punës së organeve komunale (Diagrami 4).

⁶ Ligji 03 / L - nr. 040 për qeverisjen vendore, në dispozicion në <https://bit.ly/2oI592C>

⁷ Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2015 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2013 për Transparencën në Komuna

Diagrami 4. Mënyra e përmirësimit të transparencës në punën e autoriteteve dhe shërbimeve komunale



Kur krahasohen rezultatet sipas komunave, më të dukshmet janë devijimet në komunën e Zveçanit, në krahasim me tri komunat tjera. Për shembull, në komunën e Leposaviqit, 32.3% e të anketuarve janë të interesuar të kenë takime publike me Kryetarin e Komunës, ndërsa vetëm 2.4% e të anketuarve zgjedhën të njëjtën metodë në Zveçan. Për dallim nga kjo, numri më i madh i të anketuarve nga Zveçani gjithashtu deklarojnë se faqja funksionale e internetit do të rriste transparencën komunale, gjë që vë në pikëpyetje funksionalitetin e faqeve ekzistuese komunale.


Varësisht nga mosha dhe shkathtësitë kompjuterike, banorët kanë identifikuar mënyrat e marrjes së informatave, ose mënyrë se si do të donin ata të informoheshin. Sa më e madhe mosha e të anketuarve, aq më pak ata sugjerorin faqen e internetit si mënyrë e shpërndarjes së informatave. Në fakt, më pak se një e treta e këtyre të anketuarve që preferojnë përdorimin e internetit janë më të moshuar se 55 vjeç.

Njohuria për statutet komunale

Statuti i Komunës është akti më i lartë që miratohet nga kuvendi komunal në pajtim me Kushtetutën e Kosovës dhe ligjet që rregullojnë organizimin e brendshëm të komunës⁸. Komunat në veri të Kosovës kanë miratuar statutet që janë në pajtim me Ligjin, si dhe janë verifikuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal. Masa në të cilën banorët e veriut të Kosovës janë të informuar për përmbajtjen e këtij akti komunal është paraqitur në diagramin e mëposhtëm (Diagrami 5).

⁸ Ligji 03 / L - nr. 040 për qeverisjen vendore, në dispozicion në <https://bit.ly/2oI592C>

Diagrami 5. Njohja e qytetarëve me përmbajtjen e statutit të komunës, sipas komunave



Siç edhe ilustron në diagram, shumica dërmuese e të anketuarve nuk janë të njohur me përmbajtjen specifike të statuteve komunale, të miratuara nga pushteti lokal. Për më tepër, 93.6% e të anketuarve në Leposaviq, që përfaqësojnë përqindjen më të lartë në katër komunat, nuk janë fare të njohur. Edhe pse nuk është përfaqësuese, gjendja është pak më e favorshme në komunën e Mitrovicës së Veriut, ku më se 25% e të anketuarve kishin më shumë informata mbi përmbajtjen e statutit të kësaj komune. Mes të anketuarve nga të katër komunat, kategoria e studentëve është plotësisht e pajtueshme me përmbajtjen e statutit (100%), dhe pasohet shumë afër nga kategoria e të papunëve dhe amvisëve (93.7%, respektivisht 90.3%).


Ndikimi i banorëve në proceset lokale të vendim-marrjes

Pjesëmarrja e drejtpërdrejtë në funksionimin e qeverisjes në të gjitha nivelet, e sidomos në nivelin lokal, është një prej parimeve themelore të praktikave të mira demokratike dhe qeverisjes së mirë. Kjo praktikë

bazohet në të drejtën e qytetarëve për të marrë pjesë në vendim-marrje dhe politika që prekin jetën e tyre, si dhe përfshin punën e përbashkët të të gjithë akterëve në projektimin e të ardhmes së komunitetit të tyre lokal. Në nivel lokal, pjesëmarrja publike mund të ndikojë në vendimet e fushave të ndryshme: në fushën e politikave publike dhe akteve ligjore, në përgatitjen dhe miratimin e planeve dhe programeve zhvillimore, por edhe në përkufizimin e projekteve specifike në nivel lokal.

Përkundër shumë përfitimeve dhe vlerave që mund të arrihen përmes pjesëmarrjes në vendim-marrje në nivel lokal, 69,7% e të anketuarve besojnë që banorët në komunat e veriut të Kosovës nuk kanë ndikim në vendimet që merren në seancat e kuvendit komunal. Rezultatet sipas komunave janë dhënë në diagramin vijues (Diagrami 6).

Diagrami 6. Ndikimi i qytetarëve në procesin e marrjes së vendimeve nga autoritetet lokale, sipas komunave



Të anketuarit nga Mitrovica e Veriut (84.6%) pajtohen që banorët e kësaj komune nuk kanë ndonjë ndikim mbi procesin e vendim-marrjes në kuvend, ndërsa duhet theksuar që e njëjta komunë pasqyron

trendin prej 57% të banorëve të saj që janë pjesërisht apo më shumë të informuar mbi punën e komunës. Statistikat e tilla tregojnë që ka interesim tek banorët në lidhje me punën e autoriteteve komunale, por që ende nuk janë krijuar mekanizmat adekuatë për pjesëmarrje kuptimplotë në proceset vendim-marrëse që janë thelbësorë për funksionim më të mirë të komunitetit.


Në anën tjetër, në komunën e Zveçanit, shumica e të anketuarve theksojnë që banorët e kësaj komune kanë ndikim të vogël në vendim-marrje (45.2%), ndërsa 10.5% mendojnë që banorët vërtet kanë ndikim në procesin e vendim-marrjes në kuvendin komunal. Këto të dhëna janë posaçërisht interesante, duke marrë parasysh që në këtë komunë, mbi 80% e banorëve janë më pak të informuar rreth punës së komunës, ose nuk janë të informuar aspak. Mospërputhjet në përgjigje tregojnë qartë që banorët në fakt nuk kanë perceptim të qartë të konceptit të “pjesëmarrjes publike”.

Mekanizmat për paraqitjen e qëndrimeve të publikut mbi problemet dhe çështjet lokale

Për të marrë vendime më të mira, komunikimi mes autoriteteve lokale dhe banorëve duhet të jetë dydrejtëmsh. Përveç kësaj, suksemi i këtij procesi varet nga gatishmëria e banorëve që të marrin pjesë në mënyrë aktive në zgjidhjen e problemeve të komunitetit të tyre, por edhe nga hapja dhe vullneti i organeve komunale për t’i mundësuar publikut që të deklarojë nevojat e tij kurdo që është e mundur.

Cili është qëndrimi i banorëve në veri të Kosovës sa i përket kapaciteteve komunale për t’ia mundësuar publikut që të ofrojë mendimet e veta lidhur me problemet lokale dhe çështjet e interesit të përgjithshëm? Rezultatet e kësaj pyetje janë dhënë në diagramin vijues (Diagrami 7).

Diagrami 7. Mundësimi i qytetarëve që të shprehin mendimet dhe qëndrimet për komunat



Mund të shihet qartë në diagram që mbi 75% e të anketuarve besojnë që publiku në nivelin lokal duhet të jetë në gjendje të shprehë qëndrimet dhe mendimet e veta rreth çështjeve lokale dhe të tjera në kompetencën e komunave. Vetëm 3.3% e të anketuarve theksojnë që banorët nuk duhet të kenë këtë mundësi.

Në këtë drejtim, qëndrimet e të anketuarve dallojnë në masë të madhe në komunën e Mitrovicës së Veriut dhe Leposaviqit. Në Leposaviq, 97.1% e të anketuarve besojnë që publiku duhet ta ketë këtë mundësi për të gjitha çështjet lokale. Në Mitrovicën e Veriut, ndonëse shumica e të anketuarve kanë theksuar që publiku nuk ka ndonjë ndikim në vendim-marrje në komunën e tyre, vetëm 55.7% e të anketuarve besojnë që banorët duhet ta kenë këtë mundësi për të shprehur qëndrimet e tyre mbi të gjitha çështjet dhe problemet lokale.


Ndonëse kategoria e të anketuarve në moshat nga 18 deri në 25 vjeç janë kategoria më së paku e njoftuar me punën e pushteteve lokale

dhe përmbajtjen e akteve komunale, ata në masë të madhe (81%) argumentojnë që banorët duhet të lejohen të marrin pjesë në zgjidhjen e problemeve lokale.

Komunikimi i drejtpërdrejtë mes banorëve dhe përfaqësuesve komunalë

Përkundër faktit që mbi 75% e të anketuarve në komunat e veriut të Kosovës besojnë që pushtetet lokale duhet t'i mundësojnë banorëve të shprehin mendimet dhe qëndrimet e tyre, vetëm 14% e të anketuarve kanë pasur mundësi të flasin me ndonjë prej përfaqësuesve komunalë (Diagrami 8).

Diagrami 8. Mundësia e komunikimit direkt në mes të qytetarëve dhe përfaqësuesve të komunës




Diagrami më lart ilustron që 86% e të anketuarve nga të katër komunat nuk kanë pasur asnjëherë mundësi të flasin me përfaqësuesit komunalë në lidhje me një çështje apo problem lokal. Nëse e shohim këtë çështje ndaras në të gjitha komunat, komuna e Zveçanit është e veçantë, me 96.8% të të anketuarve që theksojnë se asnjëherë nuk

kanë pasur mundësi të flasin me ndonjë përfaqësues të autoriteteve komunale. Kur trajtohen përgjigjet sipas moshave, kategoria me më së paku mundësi të kontaktimit me përfaqësuesit e autoriteteve lokale janë të rinjtë e moshave 18 deri në 25 vjeç. Megjithëse 76.5% e të anketuarve të rinj thanë se publiku duhet të jetë në gjendje të shprehë pikëpamjet e tij për çështjet dhe problemet lokale, 97% deklaruan se nuk kishin pasur kurrë mundësi që të flasin drejtpërdrejt me ndonjë përfaqësues të autoriteteve komunale. Ky informacion tregon qartë se ekziston mungesë e mekanizmave të krijuara që do të ngritnin çështjet e publikut në nivelin e autoriteteve lokale; apo kjo gjetje mund të tregojë gjithashtu se publiku është mjaft pasiv në lidhje me prezantimin e çështjeve apo problemeve të komunitetit tek përfaqësuesit komunalë.

Në mesin e 14% të të anketuarve që kanë pasur mundësi të flasin drejtpërsëdrejti me përfaqësuesit e komunës, temat e ngritura kishin të bënin me punësimin dhe krijimin e vendeve të punës (22.3%), si dhe çështjet e strehimit (9.7%). Këto të dhëna tregojnë se të anketuarit iu drejtuan përfaqësuesve të komunave, kryesisht për probleme private/personale, ndërsa komunikimi në lidhje me problemet e komunitetit ishte më pak i përfaqësuar. Mirëpo, në diskutimin e problemeve kolektive të komunitetit, ndër temat më të shpeshta ishin problemet me shërbime komunale (8.7%), problemet infrastrukturore, kryesisht rrugët lokale (7.8%), si dhe përmirësimi i situatës së sigurisë (5.8%).

Diagrami 9. Problemet e diskutuar me përfaqësuesit e komunës



Prania e banorëve në takimet publike ose seancat e kuvendit komunal

Seancat e kuvendit komunal dhe komiteteve të tij janë të hapura për publikun. Pjesëtarëve të publikut u lejonet të monitorojnë dhe të marrin pjesë në seancat e kuvendit komunal në mënyrën e përcaktuar

në Rregulloren e punës së komunës⁹. Përveç kësaj, secila komunë duhet të mbajë periodikisht dhe të paktën dy herë në vit takim publik ku mund të marrë pjesë çdo person ose organizatë e interesuar¹⁰. Përkundër këtyre dispozitave ligjore për pjesëmarrjen dhe përfshirjen dhe mekanizmat e demokracisë së drejtpërdrejtë dhe pjesëmarrjes publike, 94% e të anketuarve kurrë nuk kanë marrë pjesë në ndonjë mbledhje publike ose seancë të asamblesë që u organizua nga komuna e tyre.

Në këtë drejtim, të anketuarit e moshës 15-24 vjeç, pa përjashtim dhe pavarësisht komunës nga e cila vijnë, deklaruan se nuk kanë qenë kurrë pjesë e ndonjë takimi publik apo seance të asamblesë të organizuar nga komuna e tyre. Për më tepër, gjetjet e mëparshme tregojnë se kjo kategori e të anketuarve më së shumti ndikohet nga mungesa e interesimit në aktivitetet e organizuara nga përfaqësuesit e autoriteteve komunale lidhur me punën e komunës.

Pjesëmarrësit në seancat e kuvendit komunal dhe takimet publike kanë tendencë të jenë të anketuar të punësuar (11.3%) dhe amvise (6.7%), ndërsa 100% e të papunëve dhe kategoria e studentëve nuk kanë ndjekur asnjë nga takimet. Gjetjet mund të shërbejnë si të dhëna bazë për zyrtarët e pushtetit lokal për atë se cilat kategori të banorëve duhet të inkurajohen më shumë për të shfytëzuar të drejtat e tyre për vijimin e mbledhjeve dhe seancave. Përveç kësaj, pushtetet lokale do të mund të përdorin edhe mekanizmat e përcaktuar me ligj për pjesëmarrje në vendimmarrje dhe zgjidhje të problemeve në nivel lokal.

⁹ Ligji nr. 03 / L - nr. 040 Për Vetëqeverisjen Lokale, Neni 45, në dispozicion në <https://bit.ly/2oI592C>

¹⁰ Ligji nr. 03 / L - nr. 040 Për Vetëqeverisjen Lokale, Neni 64.1, në dispozicion në <https://bit.ly/2oI592C>

Disa, ose 6% e numrit të përgjithshëm të të anketuarve, shfrytëzuan të drejtën e tyre për të marrë pjesë në mbledhjet publike dhe seancat komunale. Temat që prekën interesimin e të anketuarve ishin zgjedhjet lokale dhe çështjet urbane, përkatësisht rregullimi i zonave publike. 15.6% e të anketuarve kanë marrë pjesë në dëgjimet publike për buxhetin komunal për vitin aktual, duke treguar interesim edhe për temat mbi sigurinë, infrastrukturën lokale dhe problemet e banorëve (6.3% për secilin). Shkalla në të cilën të anketuarit ishin interesuar për temat e mësipërme dhe tema të tjera në seancat dhe takimet publike është treguar në grafikun e mëposhtëm (Grafiku 10).

Diagrami 10. Prania e qytetarëve në takimet publike në tema të veçanta




Megjithëse shumica e të anketuarve nuk kanë marrë pjesë në tubimet publike dhe seancat e kuvendit të organizuara nga komunat e tyre, shumicës dërrmuese të tyre që kishin marr pjesë (94.3%) iu dha mundësia për të komentuar mbi çështjet. Për më tepër, të gjithë të anketuarit nga komuna e Leposaviqit, Zubin Potokut dhe Zveçanit që kanë marrë pjesë ndonjëherë në takimet publike ose seancat e kuvendit ishin në gjendje të shprehnin pikëpamjet e tyre, ndërsa në Mitrovicën e Veriut 10% e të anketuarve, përkundër pranisë në seanca, nuk e pati këtë mundësi.

Pjesëmarrja e publikut në miratimin e buxhetit komunal

Pjesëmarrja e banorëve në faza të caktuara të procesit të planifikimit të buxhetit nuk u realizua në praktikë në komunat e veriut të Kosovës. Në të vërtetë, vetëm 3% e të anketuarve ndoqën seancën e asamblesë në të cilën është diskutuar buxheti i komunës.

Diagrami 11. Pjesëmarrja e qytetarëve në miratimin e buxhetit komunal



Rezultatet gjithashtu tregojnë që si kategoritë e të punësuarve ashtu dhe ato të pensionistëve morën pjesë në seanca (përkatësisht 5.3% dhe 2.8%), ndërkohë që kategoritë e të papunëve, studentëve dhe amvisve nuk ishin pjesë e këtij procesi.


Ndër të anketuarit që morën pjesë në debatin e buxhetit komunal, 83.3% patën mundësi të paraqesin propozimet ose komentet. Kur ta shikojmë secilën komunë veç e veç, situata më e favorshme është në Mitrovicën e Veriut, ku të gjithë të anketuarit që morën pjesë në debatin publik mbi buxhetin komunal kishin mundësi të komentojnë ose të paraqesin ndonjë propozim me rëndësi për krijimin e buxhetit komunal. Në komunën e Zubin Potokut kanë marrë pjesë 80% e të anketuarve, në Leposaviq 75% e të anketuarve dhe më së paku në komunën e Zveçanit 66.7%. Përveç kësaj, në komunën e Zveçanit e kemi edhe numrin më të vogël të të anketuarve të cilët kishin pasur mundësi që ndonjëherë të flasin drejtpërdrejt me ndonjë përfaqësues të komunës.

Nga të anketuarit që morën pjesë në këto seanca në buxhetin komunal dhe bënë komente ose propozime, rezultatet tregojnë se në 80% të rasteve kuvendi mori në konsideratë këto kërkesa. Kjo shpie në përfundimin se seancat e kuvendit paraqesin mundësi të mirë për banorët që të shprehin mendimin apo komentet e tyre mbi buxhetin komunal përpara se të miratohet dhe në këtë mënyrë të përmirësojnë shpërndarjen e fondeve komunale.

Qasja në dokumente publike

Çdo person mund të ketë qasje në cilindo dokument komunal publik, me kusht që zbulimi i informacionit bëhet në pajtim me Ligjin për Qasje në Dokumente Publike¹¹. Kjo e drejtë e përcaktuar me ligj u përdor nga të paktën 10.4% e të anketuarve nga katër komunat në veri të Kosovës. Në mesin e tyre, shumica e kërkesave për qasje në dokumente publike janë dorëzuar nga të anketuarit nga komuna e Mitrovicës së Veriut (23.1%). Në komunat e tjera, numër dukshëm më i vogël i të anketuarve shprehën interes për qasje në dokumente publike, siç mund të shihet qartë në diagramin e mëposhtëm (Diagrami 12).

Diagrami 12. Kërkesat për qasje në dokumente publike, sipas komunave



Raporti publik për të drejtën e qasjes në dokumente publike në institucionet publike në Kosovë për vitin 2017, thekson se në 96% të kërkesave të paraqitura, është lejuar qasja për të parë dokumentet

¹¹ Ligji nr. 03 / L - nr. 040 Për Vetëqeverisjen Lokale, Neni 68.5
<https://bit.ly/2oI592C>

komunale¹². Mirëpo, situata në komunat në veri të Kosovës për këtë çështje nuk përputhet plotësisht me këtë statistikë zyrtare. Ndonëse nuk ka pasur numër të madh të kërkesave për qasje në dokumente publike në komunat në Kosovën veriore, rezultatet e të anketuarve tregojnë se gati tre të katërtat e kërkesave kanë pasur rezultat pozitiv, dmth. 72.6% e të anketuarve kanë marrë dokumentin e kërkuar publik.

Ndërgjegjësimi lidhur me buxhetin komunal

Rezultatet e anketës tregojnë se 21.3% e të anketuarve nga komuna e Mitrovicës së Veriut janë informuar për sasinë e buxhetit për vitin aktual (2018). Në Zubin Potok, vetëm 2.7% janë të njoftuar me shumën e buxhetit, ndërsa në Leposaviq 5% e të anketuarve ishin në dijeni për buxhetin komunal. Në përgjithësi, niveli i ulët i informacionit në lidhje me buxhetin komunal mund t'i atribuohet mungesës së funksionalitetit të faqeve të internetit të komunave, pasi që numër i konsiderueshëm i të anketuarve deklaruan se përdorin internetin si mjet kryesor për informimin rreth aktiviteteve komunale (24%). Është veçanërisht interesante që vetëm komuna e Zveçanit ka portal modern në internet, por nuk është publikuar asnjë informacion mbi sasinë dhe përmbajtjen e buxhetit komunal për vitin 2018.

Ndërgjegjësimi rreth infrastrukturës komunale ose projekteve zhvillimore


Në disa vitet e fundit, në komunat në veri të Kosovës, kanë investuar fonde të konsiderueshme nga burime të ndryshme financimi për

¹² Një raport gjithëpërfshirës për ushtrimin e së drejtës për qasje në dokumente publike në institucionet publike në Kosovë për vitin 2017, në dispozicion në <https://bit.ly/2Dt16Bd>

zhvillimin e infrastrukturës komunale. Vlen të theksohet, vetëqeverisjet lokale filluan me realizimin e 179 projekteve infrastrukturore dhe zhvillimore në periudhën 2013 - 2016¹³. Ndonëse rezultatet e anketës treguan se banorët në masë të madhe nuk ishin pjesë e procesit të vendimmarrjes kur u ballafaquan me projektet zhvillimore në komunën e tyre, pothuajse një e treta e të anketuarve janë ende të vetëdijshëm për atë se cilat projekte po zbatohen në komuna.

Në Mitrovicën e veriut të anketuarit janë më së shumti të njohur me infrastrukturën dhe projektet zhvillimore, dmth. 60.2% e të anketuarve kanë thënë se e dinë cilat projekte komunale po zbatohen. Ky nivel i njohurisë rreth projekteve infrastrukturore dhe zhvillimore në komunë është shumë më i lartë se sa vetëdija e banorëve në komunat e tjera, gjë që mund të shihet në Diagramin 13.

Diagrami 13. Njohja me infrastrukturën komunale dhe projektet zhvillimore, sipas komunave



¹³ Studimi "A jetojmë më mirë", në TER 2016, në dispozicion në <https://bit.ly/2A7Clio>

Numër shumë i vogël i të anketuarve në komunën e Zveçanit, të cilët, pavarësisht projekteve të mëdha dhe të shumta infrastrukturore që realizohen në territorin e komunës së tyre, e dinë që ato janë duke u realizuar aktualisht, vetëm 2.4% e të anketuarve. Në komunat e Leposaviqit dhe Zubin Potokut, këto statistika janë më të favorshme, por ende e pakënaqshme, duke marrë parasysh vëllimin e investimeve dhe numrin e projekteve që po realizohen atje.


Në Mitrovicën e veriut, shumica e të anketuarve janë të informuar për projektet si ndërtimi i bulevardit (23%), pastaj ndërtimi i objekteve të banimit (20.9%), ndërtimi i një deponie rajonale dhe qendrës së riciklimit (15.5%), prishja e ndërtimeve pa leje (13.5%), ndërtimi i qendrës sportive (7.8%) dhe rinovimi i rrugëve dhe trotuareve (7.8%). Zbatimi i këtyre projekteve ka çuar në ndryshime të mëdha dhe shumë të dukshme në pamjen e komunës, gjë që me siguri ka kontribuar në faktin se banorët janë shumë mirë të informuar për projektet që po realizohen ose zbatohen në territorin e komunës së tyre.

Në Zveçan, vetëm 2.4% e të anketuarve janë të njoftuar me projektet infrastrukturore që po zbatohen dhe kanë të bëjnë me ndërtimin e ujësjellësit rajonal, ndërtimin e objekteve për aktivitete sportive, ndërtimin e banesave për personat e cenueshëm social dhe projekte për ngritjen e vetëdijes për grupet e marginalizuara të shoqërisë, ndërtimin e kompleksit Rajska spa complex dhe restaurimin e rrugëve dhe trotuareve. Është e çuditshme që asnjë nga të anketuarit nuk ka deklaruar apo treguar se ka informata për një projekt të madh infrastrukturor që po zbatohet në Zveçan, një zhvillim i vendbanimeve urbane “Sunčana dolina”, ndërtimi i të cilave filloi në vitin 2016.

Në Zubin Potok, 31.8% e të anketuarve janë të vetëdijshëm se janë duke u zhvilluar projekte në komunën e tyre për rindërtimin e rrugëve ekzistuese dhe për ndërtimin e rrugëve të reja lokale. 29.5% e të

anketuarve ishin të informuar për ndërtimin e pishinës së brendshme, dhe 22.7% për projektin për ndërtimin e sistemit rajonal të furnizimit me ujë. Zbatimi i projekteve tjera është më pak i njohur për banorët, gjë që mund të shihet në Diagramin 14.

Diagrami 14. Njoftimi I qytetarëve të komunës së Zubin Potok-ut me projektet të cilat i zbaton komuna e tyre



Më shumë se gjysma e të anketuarve (51.6%) nga Leposaviqi janë të informuar se komuna e tyre po ndërton pishinë të qytetit, ndërsa 29% janë të njohur me projektin e rindërtimit të ndërtesës komunale. Të dy projektet kanë pasur shumë vëmendje nga banorët nga të katër komunat. Projekti i ndërtimit të pishinës së qytetit ka kaluar nëpër një numër të diskutimeve në kuvendin komunal në Leposaviq sepse ishte e qartë se si ishte paguar organizimi i përkohshëm i ndërtimit, pasi shumica e fondeve të shpenzuara nuk pasqyrojnë gjendjen aktuale në

teren. Derisa projekti i rindërtimit të objektit komunal ishte iniciuar pavarësisht nga procedurat ligjore dhe me burime financiare disi të paqëndrueshme, realizimi i tij ishte vënë vazhdimisht në pikëpyetje. Banorët e kësaj komune deri diku e dinë se janë duke u realizuar projekte për rindërtimin e rrugëve rurale dhe lokale (9.7% dhe 3.2%), si dhe projekte të peizazhit publik (3.2%).

V KONKLUDIM

Informimi i banorëve mbi punën e vetëqeverisjes lokale është faktor shumë i rëndësishëm që mund të lehtësojë paragjykimet e mundshme dhe mungesën e besimit. Ky hulumtim ka treguar se niveli i njohurive të publikut mbi punën e komunave të tyre nuk është në nivel të lartë. Gjetja mund t'iu atribuohet banorëve të cilët nuk janë aktivë në marrjen e informacionit, ose që qeveritë lokale nuk përdorin mekanizmat në dispozicion për shpërndarjen e informatave, duke mos arritur kështu tek të gjithë banorët. Meqënëse mekanizmat për përmirësimin e rrjedhës së informacionit qëndrojnë në duart dhe kompetencat e komunave, është shumë e rëndësishme që vetë komunat të luajnë rol proaktiv në komunikimin me banorët, duke i prezantuar atyre aktivitetet, planet, vendimet e marra dhe të ngjashme.

Përmes analizës së të dhënave të mbledhura, rezultati është që publiku më së shumti informohet mbi punën e pushtetit lokal përmes komunikimit të drejtpërdrejtë me miqtë dhe të njohurit, gjë që mund të hapë derën për interpretim të ndryshëm të të njëjtit informacion. Formë tjetër dominuese e rrjedhës së informacionit është përmes internetit, gjë që çon në përfundimin se informacioni i disponueshëm për publikun duhet të gjendet në uebfaqet zyrtare të komunës, mirëpo aktualisht kjo nuk është kështu. Faqet e internetit funksionale me njoftime në kohë të duhur dhe dokumentet në dispozicion të komunës padyshim do të përkrahin rritjen e transparencës dhe hapjes së njësive të vetëqeverisjes lokale.

Bazuar në të gjeturat, konkluzioni është se publiku nuk është shumë i njohur me buxhetin komunal dhe se ekziston shumë pak interesim në këtë fushë, prandaj duhet të bëhen përpjekje për të rritur ndërgjegjësimin e banorëve rreth nevojës për pjesëmarrje në punën e

pushtetit lokal. Në anën tjetër, komunat gjithashtu duhet të inkurajohen që të jenë më të hapura, më transparente dhe të përpigën që në mënyrë aktive të përfshijnë banorët në procesin e vendimmarrjes në lidhje me buxhetin.

Në të njëjtën kohë, perceptimi i banorëve mbi transparencën e pushtetit lokal dhe në përgjithësi tendenca e autoriteteve lokale që në kohë të informojnë publikun për punën e tyre, për të mundësuar publikun të shprehë mendime apo të japë komente mbi çështjet dhe problemet aktuale lokale, është mjaft negativ. Një trend i tillë negativ është gjithashtu i pranishëm kur kemi të bëjmë me pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje, sepse vetëm një përqindje e vogël e të anketuarve (14%) konfirmuan se ishin në gjendje të paraqesin mendimin e tyre tek ndonjë përfaqësues i pushtetit lokal.

Mirëpo, është inkurajuese që shumica dërrmuese e të anketuarve (75%) mendojnë se komunat duhet t'u mundësojnë banorëve të shprehin mendimet dhe pikëpamjet e tyre për çështjet lokale. Gjetjet e tilla tregojnë se publiku në përgjithësi kupton përfitimet e komunikimit me dy drejtime ndërmjet banorëve dhe vetëqeverisjes lokale. Nëse janë krijuar mekanizma të caktuar që mundësojnë komunikim efektiv në praktikë, përqindja e banorëve që do të shfrytëzojnë të njëjtin mund të ketë rritje të vazhdueshme, gjë që ndikon drejtpërdrejtë në trendin e transparencës komunale.

SHTOJCA 1

Tabela: *Madhësia e mostrës, nivelet e besimit dhe intervalet e besimit për mostrat e rastësishme*¹⁴

Madhësia e popullatës	Niveli i besimit 90%			Niveli i besimit 95%			Niveli i besimit 99%		
	Intervali i besimit			Intervali i besimit			Intervali i besimit		
	5%	4%	3%	5%	4%	3%	5%	4%	3%
30	27	28	29	28	29	29	29	29	30
50	42	45	47	44	46	48	46	48	49
75	59	64	68	63	67	70	67	70	72
100	73	81	88	79	86	91	87	91	95
120	83	94	104	91	100	108	102	108	113
150	97	111	125	108	120	132	122	131	139
200	115	136	158	132	150	168	154	168	180
250	130	157	188	151	176	203	182	201	220
300	143	176	215	168	200	234	207	233	258
350	153	192	239	183	221	264	229	262	294
400	162	206	262	196	240	291	250	289	329
450	170	219	282	207	257	317	268	314	362
500	176	230	301	217	273	340	285	337	393
600	187	249	335	234	300	384	312	380	453
650	192	257	350	241	312	404	328	400	481
700	196	265	364	248	323	423	341	418	507
800	203	278	389	260	343	457	363	452	558
900	209	289	411	269	360	468	382	482	605
1000	214	298	431	278	375	516	399	509	648
1100	218	307	448	285	388	542	414	534	689
1200	222	314	464	291	400	565	427	556	727

¹⁴ Teknikat e mostrimit në hulumtime arsimore, Autor: Dr. E.

Dhivyadeepa, faqet 20 dhe 21, gjendet tek <https://bit.ly/2KmFJ42>

1300	225	321	478	297	411	586	439	577	762
1400	228	326	491	301	420	606	450	596	796
1500	230	331	503	306	429	624	460	613	827
2000	240	351	549	322	462	696	498	683	959
2500	246	364	581	333	484	749	524	733	1061
5000	258	392	657	357	536	879	586	859	1347
7500	263	403	687	365	556	934	610	911	1480
10000	265	408	703	370	566	964	622	939	1556
20000	269	417	729	377	583	1013	642	986	1688
30000	270	419	738	379	588	1030	649	1002	1737
40000	270	421	742	381	591	1039	653	1011	1762
50000	271	422	745	381	593	1045	655	1016	1778
100000	272	424	751	383	597	1056	659	1026	1810
150000	272	424	752	383	598	1060	661	1030	1821
200000	272	424	753	383	598	1061	661	1031	1826
250000	272	425	754	384	599	1063	662	1033	1830
500000	272	425	755	384	600	1065	663	1035	1837
1000000	272	425	756	384	600	1066	663	1036	1840

SHTOJCA 2

Pyetësoni

I/e nderuar,

Pyetësoni është pjesë e hulumtimit që po kryhet për të mbledhur dhe vlerësuar nivelet e informacionit mbi transparencën e strukturave komunale në veri të Kosovës, si dhe qasjen komunale ndaj vendimmarrjes në nivel lokal. Hulumtimi është duke u zhvilluar nga Instituti për Zhvillimin Ekonomik të Territorit (InTER)

Ju lutemi merrni pjesë në hulumtim dhe plotësoni pyetësonin. Informacioni që na është dhënë do të jetë plotësisht konfidencial dhe emri dhe adresa juaj nuk do të publikohen në asnjërin nga raportet që publikojmë.

Faleminderit paraprakisht që keni ndarë kohë për të marrë pjesë në këtë hulumtim!

I INFORMATA TË PËRGJITHSHME

1. **Gjinia:** 1) Mashkul 2) Femër
2. **Mosha:** _____
3. **Niveli i arsimimit**
 1. Pa arsim formal
 2. Shkollë fillore
 3. Shkolla e mesme
 4. Shkolla e lartë
 5. Universiteti

4. Profesioni:

1. I/e punësuar
2. Pensionist
3. Amvisë
4. I/e papunë
5. Student
6. Të tjera, ju lutem specifikoni: _____

II QËNDRIMET NDAJ TRANSPARENCËS KOMUNALE

5. Sa të informuar jeni për punën e komunës?

1. Plotësisht i/e informuar
2. Kryesisht i/e informuar
3. Pjesërisht i/e informuar
4. Pak i/e informuar
5. I/e painformuar

6. Si informoheni për punën e komunës?

1. Përmes kontaktit të drejtpërdrejtë me përfaqësuesit/in e komunës
2. Përmes miqve/të njohurve që e dinë se çfarë po ndodh
3. Përmes internetit dhe/ose rrjeteve sociale
4. Përmes stacioneve televizive lokale dhe rajonale
5. Përmes radio stacioneve lokale dhe rajonale
6. Gazetave
7. Nga asnjë burim
8. Të tjera, specifikoni _____

7. Sa të kënaqur jeni me aktivitetet informuese të komunës suaj?

1. Plotësisht i/e kënaqur
2. Kryesisht i/e kënaqur
3. Pjesërisht i/e kënaqur
4. Pak i/e kënaqur
5. I/e pakënaqur

8. A e dini nëse komuna ka / duhet të ketë zyrtar komunal për informim?

1. Po
2. Jo

8.a Nëse po, sa jeni të njohur me kompetencat e zyrtarit komunal për informim?

1. Plotësisht
2. Pjesërisht
3. Aspak

9. Si mund të përmirësohet transparenca e autoriteteve komunale dhe shërbimeve komunale? (mund të jepen disa përgjigje)

1. Faqe interneti komunale funksionale që vë në dispozicion të gjitha aktet relevante komunale dhe informatat publike
2. Informata kthyesë më efikase për kërkesat për qasje në dokumente publike
3. Debate publike para miratimit të akteve relevante (projektbuxhetit, strategjive, planeve të zhvillimit urban, etj)
4. Takime publike me kryetarin e komunës
5. Takime publike/debate mbi çështje të rëndësishme për zhvillimin e komunës
6. Zhvillimi dhe zbatimi i udhëzimeve administrative për transparencën e punës së komunës
7. Zhvillimi dhe zbatimi i planit të veprimit lidhur me transparencën
8. Të tjera, ju lutemi shënoni _____

10. A jeni njohur me statutin e komunës në komunën tuaj?

1. Po
2. Jo

11. A mendoni se banorët kanë ndikim në proceset vendimmarrëse në kuvendin komunal?

1. Po kanë
2. Deri diku
3. Nuk kanë ndikim fare

12. A duhet që komuna t'iu mundësojë banorëve të saj që të paraqesin pikëpamjet dhe qëndrimet e tyre lidhur me çështjet dhe problemet lokale?

1. Duhet
2. Vetëm në rastet kur çështjet janë të rëndësishme
3. Jo, nuk duhet

13. A keni pasur mundësi të flisni drejtpërsëdrejti me përfaqësuesit komunal për çështjet që kanë rëndësi për ju dhe/ose për komunitetin tuaj?

1. Po
2. Jo

13.a Nëse po, ju lutemi jepni shpjegim të shkurtër të problemit/çështjes që keni ngritur me përfaqësuesin komunal?

14. A keni marrë pjesë ndonjëherë në takim publik apo sesion të kuvendit komunal të organizuar nga komuna juaj?

1. Po
2. Jo

14.a Nëse po, cila ishte tema? Ju lutemi shkruani

14.b Nëse po, a keni pasur mundësi të paraqisni mendimin apo komentën tuaj?

1. Po
2. Jo

15. A keni marrë pjesë ndonjëherë në diskutim publik për buxhetin komunal?

1. Po
2. Jo

15.a Nëse po, a keni pasur mundësi për të dhënë ndonjë koment/sugjerim tjetër gjatë diskutimit publik mbi buxhetin komunal?

1. Po
2. Jo

15.b A ishte marr para sysh sugjerimi/komenti juaj nga kuvendi komunal?

1. Po
2. Jo

16. A keni kërkuar ndonjëherë qasje në dokumente publike në komunën tuaj dhe çfarë ishte rezultati?

1. Po
a) kam pranuar dokumentin e kërkuar b) nuk e kam pranuar dokumentin
2. Jo

17. A e dini madhësinë e buxhetit komunal për vitin e ardhshëm?

1. Po
2. Jo

18. A jeni në dijeni për projektet infrastrukturore apo zhvillimore që janë duke u realizuar në komunën tuaj?

1. Po
2. Jo

18.a Nëse po, ju lutemi shënoni disa nga projektet më të rëndësishme që janë duke u realizuar në komunën tuaj.



**INSTITUTI PËR ZHVILLIMIN
EKONOMIK TERRITORIAL (INTER)
THE NORTH CITY
ÇIKA JOVINA BB II/9
MITROVICA VERIORE
OFFICE@REGIONALNIRAZVOJ.ORG
WWW.REGIONALNIRAZVOJ.ORG**